



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.12/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) dega në Gjilan, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.12.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) dega në Gjilan, ZP.Anr.12/2025 e datës 10.12.2025, me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të ndryshoj vendimin me nr. Protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të miratoj vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të vendvotimit në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 10.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) dega në Gjilan, me të cilën pretendojnë se me 8.10.2025, KQZ ka miratuar vendimin nr. 01/3693-2025 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht.

Me këtë ankesë theksohet se bazuar në nenin 3, pika 1,2,2.1 dhe 2.2 e Rregullores Zgjedhore nr.11/2024, e datës 08.03.2024, për Këshillat e Vendvotimeve, në mënyrë detajuese dhe përfundimtare përcakton se KQZ fton subjektet politike të certifikuara të cilat kanë kaluar prapun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, që të nominojnë nga një (1) anëtar për KVV.

KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet duke bazuar në numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal. Më datë 08 dhjetor 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendim lidhur përfaqësimin në Këshillat e Vendvotimeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe Komunën e Gjilanit, për zgjedhjet qendrore që do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Sipas këtij vendimi, subjekti politik KDTP — Kosova Demokratik Türk Partisi (Dega në Gjilan) është jashtëzakonisht i dëmtuar, pasi nga gjithsej 133 Këshilla të Vendvotimeve, është paraparë të përfaqësohet me 0 kryesues, vetëm 20 anëtarë dhe 3 anëtarë rezervë. Kjo situatë bie ndesh me faktin se në Komunën e Gjilanit jetojnë 745 qytetarë të komunitetit turk, si dhe me faktin tjetër se ky komunitet ka fituar përfaqësimin në Kuvendin Komunal për herë të pestë radhazi. Gjithashtu, subjekti KDTP nuk përfaqësohet fare edhe në Qendrat e Numërimit të Votave, duke pamundësuar kështu mbrojtjen dhe numërimin e votave të subjektit dhe kandidatëve tanë.

Me tutje në ankesë theksohet se arsyetimi i dëmtimit të komunitetit turk në Komunën e Gjilanit, si pasojë e vendimit të KQZ-së të datës 08 dhjetor, qëndron në faktin se KDTP është barazuar në përfaqësim me Partinë Rome të Bashkuar të Kosovës, ku të dy subjektet kanë nga 20 përfaqësues, ndonëse komuniteti turk ka 745 qytetarë, ndërsa komuniteti rom 409 qytetarë. Të tri partitë boshnjake (VAKAT, SDU dhe NDS) së bashku kanë 9 përfaqësues në KVV, edhe pse në Komunën e Gjilanit jetojnë vetëm 66 qytetarë të komunitetit boshnjak. KQZ, me këtë vendim, ka shkelur nenin 3, pikën 2.1 të Rregullores nr.11/2024, e cila qartë përcakton se përfaqësimi në KVV duhet të bazohet në numrin e popullatës brenda komunës, qka nuk është respektuar fare në raport me komunitetin turk në Gjilan. Po ashtu, KQZ ka shkelur edhe nenin 3, pikën 2.2, i cili parashikon përfaqësimin në KVV në bazë të numrit të votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel komunal dhe qendror. Sa i përket pikës 2.2 dëshirojmë t'i theksojmë edhe këto shkelje të pretenduara, të cilat janë si vijon: Subjekti politik NISMA do të përfaqësohet me 30 komisioner, edhe pse nuk ka fituar mandatin në Kuvendin Komunal të Gjilanit dhe ka marrë gjithsej 353 vota, ndërsa KDTP ka fituar mandatin me 854 vota. Partia e Ballit Demokrat Kombëtar do të ketë 10 komisioner, edhe pse nuk përfaqësohet fare në Kuvendin Komunal. Subjekti politik FJALA do të ketë 14 komisioner, ndonëse po ashtu nuk përfaqësohet në Kuvendin Komunal të Gjilanit. Përveq faktit që KDTP është përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Gjilanit për herë të pestë radhazi, e njejta përfaqësohet edhe në Kuvendin e Kosovës me 2 deputetë, siç parashihet nga Kushtetuta. Gjithashtu, që nga viti 2007, gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare në Komunën e Gjilanit. Në të gjitha proceset zgjedhore të mbajtura në Gjilan, KDTP ka pasur të drejtë të përfaqësohet në secilin Këshill të Vendvotimit me nga 1 anëtar, duke pasur gjithsej 130 përfaqësues në KVV. Është me rëndësi të theksohet se ne, si subjekt politik turk në Gjilan, nuk jemi kundër asnjë partie të asnjë komuniteti, por vendimi i KQZ-së po na mohon të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta, traktatet ndërkombëtare, ligjet dhe legjislacioni sekondar. Duke marrë parasysh rrethanat e lartcekura, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) dhe komuniteti joshumicë turk në Komunën e Gjilanit, si palë të dëmtuara nga vendimi i KQZ-së i datës 08 dhjetor 2025, i propozojnë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) që të aprovohet ankesa jonë dhe çështja të kthehet në KQZ,

me udhëzimin që vendimi të ndryshohet, në mënyrë që komuniteti turk në Komunën e Gjilanit, përmes KDTP-së, të përfaqësohet në secilin Këshill të Vendvotimit me nga një anëtar, ashtu siç ka qenë praktika, duke pasur gjithsej 130 përfaqësues.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se bazuar në Ligji nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka emëruar “Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KVV). Ky vendim është marrë duke u mbështetur plotësisht në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore nr. 11/2024, të cilat rregullojnë mënyrën e nominimit, përzgjedhjes dhe caktimit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve.

Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, kanë të drejtë të nominojnë nga një (1) anëtar në KVV. Po ashtu, përfaqësim edhe subjekteve politike të reja të certifikuara për zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV, ku KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Tek përfaqësimi i komuniteteve në KVV, përcakton numrin e dallueshëm të popullsisë brenda komunave, numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal. KQZ ka vazhduar duke marrë për bazë edhe kriteret tjera shtesë: KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara, nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme (28 Dhjetorit), KKZ ka të drejtë t’i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet.

Subjekti Politik KDTP është i përfaqësuar në Këshillat e Vendvotimeve në 7 komuna si vijon: Në Gjilan është i përfaqësuar me 20 anëtar dhe 3 rezerva; në Mitrovicë e Jugut është i përfaqësuar me 11 anëtar dhe 1 rezervë; në Lipjan është i përfaqësuar me 8 anëtar dhe 1 rezervë; në Prishtinë është i përfaqësuar me 50 anëtar dhe 5 rezerva; në Prizren është i përfaqësuar me 2 kryesues, 96 anëtar dhe 9 rezerva; në Vushtrri është i përfaqësuar me 15 anëtar dhe 1 rezervë dhe në Mamushë 2 kryesues, 204 anëtar dhe 21 rezerva.

KQZ gjatë hartimit të formulës ka ndjekur parimin e gjithëpërfshirjes ku të gjitha subjekteve politike të certifikuara për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ju ka dhënë përfaqësim në Këshillat e Vendvotimeve. Logjika në të cilën është bazuar ankesa e subjektit politik është përjashtuese ndaj komuniteteve tjera jo shumicë në Kosovë duke theksuar se ky subjekt është i përfaqësuar në Kuvendin Komunal në Gjilan dhe për atë duhet ti jepet me shumë përfaqësim sesa subjekteve tjera nga komunitetet jo shumicë. Vlen të theksohet se në Prishtinë KDTP si subjekt politik edhe pse nuk është i përfaqësuar në Kuvendin Komunal, i është dhënë e drejta e përfaqësimit në 50 vendvotime dhe 5 rezerva.

- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, vëren se ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se vendimi i KQZ-së, me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, lidhur me mos emërimin e drejtë të anëtarëve të tyre nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP), është e pabazuar.

Me nenin 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, përcaktohet se *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ."* Po ashtu me nenin 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë"*. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që *"Pavarësisht paragrafit paraparak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni"*.

Po ashtu edhe me nenin 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore nr.16/2024, për Qendrat Komunale të Numërimit, përcaktohet se *"KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse"*. Paragrafi 2 i Rregullores përcaktohet se *"Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale"*. Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore përcakton se *"Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve"*.

Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve përcaktohet se *"KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal"*.

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, ka shkelur nenin 3, pikën 2.1 të Rregullores nr.11/2024, e cila qartë përcakton se përfaqësimi në KVV

duhet të bazohet në numrin e popullatës brenda komunës, çka pretendohet se nuk është respektuar fare në raport me komunitetin turk në Gjilan. KQZ nuk ka shkelur dispozitën e nenit 3, pikën 2.2, i cili parashikon përfaqësimin në KVV në bazë të numrit të votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel komunal dhe qendror.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se në të gjitha proceset zgjedhore të mbajtura në Gjilan, KDTP ka pasur të drejtë të përfaqësohet në secilin Këshill të Vendvotimit me nga 1 anëtar, duke pasur gjithsej 130 përfaqësues në KVV, pasi që ne zgjedhjet lokale KDTP ka pasur 20 anëtar te KVV dhe 3 anëtar rezervë, ndërsa ne zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të mbajtura me 9 shkurt 2025 KDTP ne Komunën e Gjilanit ka pasur 25 anëtar dhe 2 anëtar rezervë ne KVV.

Ne këto rrethana PZAP konstatoi se me rastin e përcaktimit të numrit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, KQZ ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektin politik Kosova Demokratik Türk Partisi i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ në 7 Komuna me gjithsej 204 anëtarë në Këshillat e Votimit, prej tyre 4 kryesues, dhe 21 rezervë.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituara, pasi që subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi, është i përfaqësuar në KVV në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të fundit në nivel komunal dhe nacional, e po ashtu edhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024.

Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për dëmtimin e komunitetit turk, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit turk është i përfaqësuar në 7 komuna, me gjithsej 204 anëtarë në Këshillat e Vendvotimit, prej tyre 4 kryesues, dhe 21 rezervë, duke marrë për bazë se në nenin 3 paragrafi 1 të Rregullores 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve ndër të tjera përcaktohet se *“...se KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV për të gjitha komunitetet duke u bazuar në numrin e dallueshëm të popullatës brenda një komune dhe numrin e votave të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur atë se subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi është dëmtuar me këtë vendim dhe se duhet ti jepet me shumë përfaqësim sesa subjekteve tjera nga komunitetet jo shumicë nuk qëndron, dhe se KQZ-ja ishte e detyruar ti caktonte subjektin politik që ka numrin më të madh të votave të komunitetit turk në komunën e sipërcituar, Paneli vlerëson se sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk është obligative që numri i anëtarëve në KVV, të jetë i njëjtë për subjektet politike që vijnë nga radha e komuniteteve.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119. 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
ZP.Anr.12/2025, datë 13.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.